



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 218 Prot.

Tiranë, më datë 28.05.2019

VENDIM

Nr.180, datë 28.05.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT RESTAURIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 28.05.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: “Konservimi dhe restaurimi i pikturës murale të kishës “Shën Konstandini dhe Elenës”, Lagjja “Kala”, Berat, hartuar nga specialistët e IMK;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Elva MARGARITI

